Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** ____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)***Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

OBJEKTI I PROCEDURËS:

"NDËRTIMI I PJESSHËM I KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE, FAZA VI"
Dendësimi i matjeve gravimetrike të rendit III në pjesën qendrore dhe jugore të Shqipërisë dhe llogaritja e gjeoidit gravimetrik

HYRJE

Në përputhje me ligjin nr.72/2012, datë 28.06.2012, "*Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë*", konkretisht nenin 7, pika b, si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 669, datë 07.08.2013 (i ndryshuar), "*Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si metadatë*", Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) është institucioni përgjegjës për projektimin, ndërtimin, mirëmbajtjen dhe përditësimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH).

Në bazë të kësaj përgjegjësie ligjore, ASIG është angazhuar me burime njerëzore dhe financiare për implementimin e një Kornize Referuese Gjeodezike Moderne, unike dhe konsistente me Kornizat Referuese Gjeodezike Evropiane dhe Ndërkombëtare.

Kjo kornizë mundëson:

- sigurimin e bazës mbështetëse dhe kontrollit gjeodezik në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë;
- unifikimin e të gjitha punimeve gjeodezike, hartografike, inxhinierike dhe shkencore;
- ndërtimin e elementit bazë të Infrastrukturës Kombëtare të të Dhënave Gjeohapësinore (NSDI), sipas Direktivës INSPIRE;
- përdorimin e informacionit gjeohapësinor të saktë dhe të besueshëm nga institucionet publike, subjektet private dhe të gjithë përdoruesit.

Në kuadër të implementimit të Kornizës Referuese Gjeodezike Moderne, ASIG ka realizuar deri më tani 5 (pesë) faza kryesore, sipas aktiviteteve të mëposhtme:

1. Ndërtimi i pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike, Faza I (2018)

- Ndërtimi i Rrjetit GNSS Aktiv dhe Pasiv "ALBCORS" dhe Rrjetit Pasiv të Rendit të Parë.
- Ndërtimi i Rrjetit Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Parë (42 pika).
- Ndërtimi pjesor i Rrjetit Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Dytë (38 pika) dhe të Tretë (138 pika) në zonën Tiranë–Durrës, i bazuar në Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit Zero (3 pika absolute) të matur në 2015, mbështetur nga autoriteti suedez Landmäteriet.

- Ndërtimi i Rrjetit Shtetëror Mareografik.
- Ndërtimi i Rrjetit Shtetëror Magnetometrik.

2. Ndërtimi i pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike, Faza II (2019)

- Instalimi i pjesëve të rrjetit aktiv ALBCORS (27 stacione CORS dhe qendra e monitorimit GNSMART).
- Llogaritja e koordinatave të 27 stacioneve CORS në KRGJSH.

3. Ndërtimi i pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike, Faza III (2023)

- Ndërtimi i Rrjetit Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Dytë për gjithë territorin (300 pika).
- Llogaritja e Gjeoidit Gravimetrik (ALBGEOID23.v1) me saktësi 14.1 cm.

4. Ndërtimi i pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike, Faza IV (2024)

- Matje gravimetrike relative pjesore në Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Tretë (634 pika), me dendësi: 5 km × 5 km në zonat fushore dhe 7 km × 7 km në zonat malore.
- Ndërtimi pjesor dhe realizimi i nivelimit të parë të Rrjetit Shtetëror të Nivelimit të Rendit të Parë (Durrës–Tiranë dhe Vorë–Shëngjin).
- Llogaritja e Gjeoidit Gravimetrik (ALBGEOID24.v2) me saktësi 11.7 cm.

5. Ndërtimi i pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike, Faza V (2025)

- Dendësimi i matjeve gravimetrike të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë në pjesën veriore të Shqipërisë (300 pika), me dendësi mesatare: 2 km × 2 km në zonat fushore dhe 4 km × 4 km në zonat malore.
- Përditësimi i qendrës së kontrollit dhe integrimi i 6 stacioneve CORS të vendeve fqinje (Kosovë dhe Maqedoni e Veriut) në Rrjetin GNSS Aktiv ALBCORS.
- Rillogaritja e koordinatave në kornizën KRGJSH.

Bazuar në literaturën shkencore, udhëzimet evropiane dhe ndërkombëtare, si dhe në praktikën e institucioneve homologe evropiane, ASIG vazhdon të zhvillojë dhe implementojë më tej rrjetet gjeodezike të KRGJ-së sipas standarteve bashkohore, me qëllim krijimin e referencave gjeodezike horizontale dhe vertikale moderne, të besueshme dhe me saktësi të lartë për mbështetjen e të gjitha nevojave të përdoruesve dhe aplikacioneve praktike dhe shkencore.

Në këtë kuadër, ASIG synon realizimin e aktiviteteve të mëtejshme të rrjeteve të KRGJ-së, si më poshtë:

1. Dendësimi i Rrjetit Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Tretë (Pjesa Qendrore dhe Jugore)

Në këtë aktivitet do të realizohen matje gravimetrike relative tokësore për dendësimin e rrjetit gravimetrik të rendit të tretë në pjesën qendrore dhe jugore të Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga segmenti Milot–Kukës deri në kufijtë shtetërorë me Maqedoninë e Veriut dhe Greqinë. Ky aktivitet do të mundësojë mbylljen e plotë të strukturës së rrjeteve gravimetrike dhe krijimin e një baze të gjërë të dhënash gravimetrike, e cila përbën bazën kryesore për llogaritjen e gjeoidit me saktësi dhe rezolucion të lartë.

2. Llogaritja e Gjeoidit Gravimetrik

Ky aktivitet ka për qëllim llogaritjen e Gjeoidit Gravimetrik me saktësi dhe rezolucion të lartë krahasuar me modelet e mëparshme (ALBGEOID23 dhe ALBGEOID24), duke u mbështetur në të dhënat gravimetrike tokësore të përfuara nga të 4 (katër) rendet e Rrjetit Gravimetrik Shtetëror (Rendi Zero deri në Rendin III). Ky model do të sigurojë dhe përfaqësojë referencën vertikale gjeodezike moderne për përcaktimin e lartësive fizike (ortometrike dhe normale) në të gjithë territorin e vendit, duke krijuar një bazë të qëndrueshme dhe të saktë për aplikime praktike, inxhinierike dhe shkencore.

QËLLIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i këtij projekti është realizimi i densifikimit të Rrjetit Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Tretë në pjesën qendrore dhe jugore të territorit, përfshirë kompletimin e gridit gravimetrik, si dhe zhvillimi i një modeli përfundimtar të gjeoidit gravimetrik me saktësi dhe rezolucion të lartë hapësinor.

REFERENCA GJEODEZIKE

Realizimi i këtij projekti bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.669, datë 07.08.2013 (i ndryshuar), “Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e Kornizës Referuese Gjeodezike Shqiptare (KRGJSH), si metadatë”.

DENDËSIMI I RRJETIT GRAVIMETRIK TË RENDIT TË TRETË NË PJESËN QENDRORE DHE JUGORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Rrjeti Gravimetrik i Rendit III përfaqëson stadin përfundimtar të densifikimit të rrjeteve gravimetrike hierarkike (Rendi 0, I dhe II). Implementimi i densifikimit në Shqipërinë qendrore dhe jugore mundëson përmbylljen e konfigurimit hapësinor të rrjetit gravimetrik kombëtar, i cili strukturohet në formën e një gridi me shpërndarje uniforme. Kjo strukturë garanton një mbulim homogjen të territorit me të dhëna gravimetrike tokësore me densitet të mjaftueshëm, të nevojshme për përcaktimin e modelit të gjeoidit gravimetrik kombëtar me rezolucion të lartë dhe saktësi të lartë.

Zona e Zbatimit

Projekti fokusohet në dendësimin e mëtejshëm të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë në pjesën qendrore dhe jugore të Republikës së Shqipërisë.

Rrjeti i projektuar përbëhet nga rreth 615 pika gravimetrike të reja, të shpërndara në mënyrë uniforme në territor, duke respektuar kriteret teknike të mëposhtme:

- Zonat me zhvillim intensiv ekonomik, kryesisht ultësira perëndimore, do të mbulohen me një densitet mesatar: $2 \text{ km} \times 2 \text{ km}$ në zonat fushore.
- Zonat malore të vendit do të mbulohen me një densitet mesatar: $4 \text{ km} \times 4 \text{ km}$, në përputhje me kushtet dhe aksesueshmërinë e terrenit.
- Në projektimin e këtij rrjeti janë përfshirë gjithashtu pikat ekzistuese të rrjeteve klasike ALB86 (rrjeti i nivelimit dhe rrjeti i triangulacionit), me qëllim shfrytëzimin e infrastrukturës gjeodezike ekzistuese dhe integrimin e saj në konfigurimin e ri të rrjetit

Në Figurën 4.1 paraqiten pikat e rrjeteve gravimetrike të matura deri më sot, për të katër rendet (pikat me ngjyrë të gjelbër), si dhe pikat që do të maten në këtë projekt të dendësimit të rrjetit gravimetrik të rendit të tretë në pjesën jugore dhe qendrore (zona e

zbatimit paraqitet me vijë të kuqe), të paraqitura me ngjyrë rozë dhe blu. Pikat me ngjyrë blu janë njëkohësisht edhe pika të referencës klasike ALB86.




Fig. 4.1. Pozicionimi i dendësimit të mëtejshëm të pikave të Rrjetit Gravimetrik të Rendit III, në pjesën qendrore dhe jugore të Shqipërisë (pikat me ngjyrë rozë dhe blu).

AKTIVITETET E REALIZIMIT TË PROJEKTIT

1. Rikonicion në terren për përcaktimin e pozicionit të 615 pikave gravimetrike të Rendit III.
2. Realizimi i matjeve gjeodezike 615 pikat e Rrjetit Gravimetrik të Rendit III.
 - Matje gravimetrike relative.
 - Matje GNSS (RTK dhe statike – ALB86) Rendit III.
3. Përpunimi i të dhënave gravimetrike dhe GNSS (statike).
4. Llogaritja e Gjeoidit Gravimetrik.

RIKONICIONI FUSHOR I PIKAVE TË RRJETIT GRAVIMETRIK III

Rikonicioni fushor do të realizohet nga operatori ekonomik (OE) dhe përfshin këto aktivitete teknike:

1. Verifikimin në terren të pozicionit paraprak të projektuar të pikave gravimetrike.
 2. Identifikimin dhe kontrollin e pikave ekzistuese të referencës të rrjetit klasik ALB86 të projektuara.
 3. Përzgjedhjen dhe përcaktimin e pozicionit përfundimtar të pikave, në përputhje me kriteret teknike dhe standardet e përcaktuara në këtë projekt.
 4. Fiksimin dhe markimin e pikave përmes gozhdëve metalike ose shufrave metalike dhe sinjalizimin e tyre me bojë (spraj).
- Pozicioni përfundimtar i pikave të reja do të miratohet nga ASIG dhe do të dokumentohet me një proces-verbal teknik, i cili do të përmbajë listën e plotë të koordinatave të të gjitha pikave të rrjetit gravimetrik III.

Rikonicioni fushor i pikave të Rrjetit Gravimetrik të Rendit III (pjesa Qendrore–Jugore)

➤ Detyrimet e Operatorit Ekonomik (OE):

1. Të përcaktojë në terren pozicionin e 615 pikave gravimetrike sipas kriterëve të përcaktuara në këtë projekt.
2. Përzgjedhja e pikave, fiksimi dhe markimi i tyre duhet të realizohet sipas këtyre kriterëve:

a) Pikat e Rrjetit Gravimetrik të Rendit III:

- Pikat duhet të vendosen në zona sa më të qëndrueshme nga pikëpamja gjeologjike dhe hidrologjike, si dhe sa më larg lumenjve dhe bregut të detit, me qëllim shmangien e ndikimeve gjeomorfologjike dhe hidrologjike.
- Pikat duhet të zgjidhen në zona që mundësojnë kryerjen e matjeve GNSS dhe të matjeve gravimetrike relative në kushte optimale.
- Pikat duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara sipas dendësisë së projektuar, me tolerancë zhvendosjeje 100–300 m (në varësi të terrenit), të vendosura në formacione gjeologjikisht të qëndrueshme.

b) Pikat e referencës klasike ALB86:

- Përfshirja e sa më shumë pikave të rrjetit ALB86 në rrjetin gravimetrik të Rendit III.
 - Mundësia e kryerjes së matjeve GNSS dhe të matjeve gravimetrike relative në pikat ekzistuese.
 - Pastrimi i hapësirës rreth reperëve, në rastin e pikave nën tokë, me përmasa minimale 30 × 30 cm.
- Për pikat e projektuara të rrjetit ALB86, në rast se gjatë rikognicionit rezulton se ato nuk gjenden, janë dëmtuar ose nuk janë të përshtatshme për realizimin e matjeve GNSS dhe gravimetrike relative, atëherë në afërsi të pozicionit të tyre do të përcaktohet një pikë e re gravimetrike e Rendit III.

Paraqitja dhe dorëzimi i pozicionit të 615 pikave përfundimtare të rrjetit gravimetrik të rendit të tretë, duhet të realizohet sipas formatit të tabelës si më poshtë:

RIKONICION	
PIKË E RRJETIT	EMËRTIMI



Pozicioni nga Harta Topo. SH - 1:25000:		Pozicioni nga ortofoto:	
			
Fotografi e vendit:			
Kordinatat Elipsoidale	$\varphi = \dots$	$\lambda = \dots$	$h \text{ (m)} = \dots$ $H \text{ (m)} = \dots$
Mënyra e sinjalizimit			
Shënime:			
Emer/Mbiemer:	Institucioni/Kompania	Nënshkrimi	
1.			
2.			
3.			
Data:			

Tabela 6.1. Formulari fushor gjatë fazës së rikonicioni.

- Për pikat e referencës ALB86, që do të përfshihen në rrjetin gravimetrik, duhet të shtohet një seksion i veçantë në tabelën e mësipërme, sipas modelit të mëposhtëm, ku të përfshihet informacioni mbi diagramën e shikueshmërisë satelitore dhe ndikimin e interferencave, pasi këto pika do të përdoren edhe si pika pasive të rrjeteve të KRGJSH të Rendit II.

Pika ALB86	Koordinatat	Diagrami i Shikueshmërisë Satelitore	Ndikimi i Interferencave
ALB86-01	φ, λ, h	Grafiku i shikueshmërisë satelitore	Vlerësim i interferencave elektromagnetike
ALB86-02	φ, λ, h	Grafiku i shikueshmërisë satelitore	Vlerësim i interferencave
ALB86-03	φ, λ, h	Grafiku i shikueshmërisë satelitore	Vlerësim i interferencave
...

Tabela 6.2. Formulari fushor i diagramës së shikueshmërisë satelitore dhe ndikimit të interferencave.

c) Fiksimi dhe markimi i Pikave të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë

- Pikat duhet të fiksohen me marka të thjeshta, si gozhda betoni ose shufra hekuri, në varësi të formacionit gjeologjik. Këto materiale janë të qëndrueshme dhe mund të mbajnë për shumë kohë, edhe nën kushte të ndryshme klimatike dhe gjeologjike.
- Emërtimi i pikave të Rrjetit Gravimetrik duhet të bëhet sipas modelit të mëposhtëm: ASIG - RIII 1073 deri në ASIG - RIII 1688. Ky sistem emërtimi mundëson identifikimin e lehtë të pikave, duke i lidhur ato me standardet dhe protokollet kombëtare të përdorura nga ASIG.
- Pikat duhet të shënohen me ngjyruet “spray” për të lehtësuar identifikimin e tyre.
- Pikat duhet të fotografohen pas përfundimit të fiksimit dhe shënimit me spray.

MATJET GJEODEZIKE TË RRJETIT GRAVIMETRIK TË RENDIT TË TRETË DHE PËRPUNIMI I TYRE (PJESA QENDRORE DHE JUGORE)

Në 615 pikat gravimetrike të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë, në pjesën Qendrore dhe Jugore të Shqipërisë, OE duhet të kryejë matje gravimetrike relative dhe matje GNSS me instrumenta të certifikuar. Të dhënat e mbledhura duhet të përpunohen dhe kompensohen sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara më poshtë, për të siguruar saktësi dhe besueshmëri maksimale të rezultateve të rrjetit gravimetrik.

Baza instrumentale për realizimin e matjeve gravimetrike relative dhe matjeve GNSS

- Gravimetrat relative të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - Të jenë të pajisura me sistem matës kuarci, i cili siguron stabilitet të lartë të sistemit matës të gravimetrit relativ, një kërkesë e domosdoshme për matjet që kryhen në funksion të ndërtimit të rrjeteve gravimetrike.
 - Të jenë të kalibruar në laborator.
 - Të kryejnë mbledhje automatike të të dhënave dhe të kenë sistem kontrolli të bazuar në laptop ose PC.
 - Të kryejnë procesim të të dhënave në kohë reale dhe ruajtjen automatike të tyre.
 - Të jenë të pajisura me paketë monitorimi për të regjistruar automatikisht të dhëna si presionin, temperaturën dhe të dhëna të tjera.
 - Të sigurojnë transferimin e të dhënave (p.sh: kartë memorie, USB etj.).
- Marrës GNSS të plotësojnë kushtet e mëposhtme:
 - Marrësit duhet të jenë minimumi dy-frekuencor (preferohen tre-frekuencor).
 - Duhet të lidhen minimalisht me dy sistemet GPS dhe GLONASS (preferohet edhe GALILEO etj.).
 - Të kenë aftësi pozicionimi me metodën Statike dhe RTK.
 - Marrësit duhet të jenë të pajisur me çertifikatë të kontrollit teknik.
- Instrumenta ndihmës për matjen e temperaturës dhe presionit të ajrit.
 - Procedura e matjeve gravimetrike relative duhet të shoqërohet njëkohësisht me matjen e temperaturës dhe presionit të ajrit.

Specifikimet teknike minimale që lidhen me performancën e gravimetrit, marrësve GNSS dhe instrumentave për temperaturën dhe presionin e ajrit paraqiten në Tabelën 7.1.1 më poshtë.

Lloji i instrumentit	Parametrat/Specifikimet	Përdorimi
Gravimetri Relativ	- Sensor kuarci me zerim elektrostatik - Rezolucion leximi: 1 mikroGal - Devijimi standard: 5 mikroGal - Diapazon përdorimi: 8000 mikroGal pa resetting - Drifti: 0,02 mikroGal/për 1 ditë - GPS onboard: Po - Kompensim automatik TILT: ± 200 arcseconds - Korrektimet automatike: Tide, Instrument Tilt, Temperature, Drift, Near Terrain, Noisy Sample, Seismic Noise Filter	Matje gravimetrike relative, mbledhje automatike të të dhënave, procesim dhe ruajtje në kohë reale

Marrës GNSS	- Minimum dy-frekuencor (preferohen tre-frekuencor) - Sistemet minimale: GPS dhe GLONASS (preferohet GALILEO) - Metoda: Statike dhe RTK - Çertifikatë kontrolli teknik	Matje pozicionimi GNSS (RTK dhe Statike)
Instrumenta ndihmës	- Sensor presioni ajri - Sensor temperature	Matje të temperaturës dhe presionit gjatë matjeve gravimetrike

Tabela 7.1. – Specifikime teknike minimale për bazën instrumentale.

Organizimi i matjeve Gravimetrike Relative dhe matjeve GNSS

Organizimi i matjeve gravimetrike relative

Operatori Ekonomik duhet të ndjekë kriteret e mëposhtme gjatë realizimit të matjeve gravimetrike relative:

- Devijimi standard në përcaktimin e vlerës së nxitimit gravitacional të forcës së rëndesës në pikat e Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë nuk duhet të kalojë 30 μ Gal.
- Matjet gravimetrike relative duhet të kryhen me metodën yll, me profile, ose me kombinim të të dyjave, në varësi të kushteve topografike dhe aksesueshmërisë së terrenit.
- Matjet duhet të fillojnë dhe të përfundojnë në të njëjtën pikë gravimetrike, që mund të jenë pika gravimetrike të Rendit të Dytë, Rendit të Parë ose pika absolute (Rendit zero).
- Në çdo itinerar, matjet ditore gravimetrike duhet të fillojnë dhe përfundojnë në të njëjtën pikë brenda ditës.
- Gjatë kthimit, rekomandohet të matet 1 pikë çdo 4–5 pika të matura gjatë vajtjes për të kontrolluar driftin e instrumentit.
- Në çdo pikë, matjet gravimetrike duhet të shoqërohen njëkohësisht me matjen e temperaturës së ambientit, presionit të ajrit dhe lartësisë së gravimetrit, me saktësi 1 mm.
- Matjet gravimetrike duhet të shoqërohen edhe me matje GNSS sipas metodës RTK, për përcaktimin e pozicionimit 3D.
- Vlera e gravitetit duhet të transformohet nga lartësia e instrumentit (gravimetrit) në sipërfaqen që i referohet lartësisë së pikëve gravimetrike të Rendit të Tretë (marka).

Organizimi i matjeve GNSS

Operatori Ekonomik duhet të ndjekë kriteret e mëposhtme gjatë matjeve fushore GNSS:

- Matjet GNSS në pikat e Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë duhet të realizohen me metodën RTK (minimalisht 30 sekonda) duke u mbështetur në Rrjetin Aktiv ALBCORS.
- Në rastet kur matjet RTK nuk mund të realizohen për arsye të ndryshme, mund të përdoret metoda fast-static (bazë-rover), duke u mbështetur në pika me koordinata të njohura në referencën KRGJSH.
- Përcaktimi i koordinatave 3D sipas metodës RTK duhet të realizohet me saktësi: $\leq \pm 5$ cm në plan dhe në lartësi.
- Për pikat e referencës ALB86 të përzgjedhura gjatë rikonicionit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - Matjet GNSS duhet të realizohen sipas metodës statike me kohëzgjatje minimalisht 2 orë.
 - Përcaktimi i koordinatave 3D duhet të realizohet me saktësi ± 1 cm në plan dhe ± 2 cm në lartësi.

- Pas-përpunimi i të dhënave duhet të realizohet duke u mbështetur në stacionet referencë të Rrjetit Gjeodezik Aktiv ALBCORS, në referencën KRGJSH.
- Fiksimi i marrësit GNSS në pikë duhet të realizohet me zhalon me lartësi fikse (1–2 m), sipas kushteve të terrenit, për të siguruar qëndrueshmëri statike gjatë gjithë procesit të matjeve.
- Matjet GNSS duhet të realizohen duke respektuar Udhëzimin nr. 3, datë 06.09.2013, “Për përcaktimin e pikave gjeodezike me ndihmën e Sistemeve Globale Satelitore të Navigimit (GNSS)”.

Procesi i matjeve gravimetrike relative

Operatori Ekonomik për realizimin e matjeve gravimetrike relative tokësore duhet të ndjekë rradhën e proceseve të mëposhtme:

1. Përcaktimi i korrëkturës së driftit stacionar për çdo gravimetër (në pika me gravitet të njohur).
2. Kalibrimi i instrumentave, duke përdorur si baza horizontale gravimetrike pikat absolute AGP01 (Shkodër), AGP02 (Tiranë) dhe AGP03 (Sarandë), ose dhe pikat gravimetrike të Rendit të Parë ndërmjet tyre.
3. Matjet gravimetrike relative në pikat e Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë, duke u mbështetur në pikat e Rendit 0 (absolute), Rendit I dhe Rendit II.

Përcaktimi i driftit stacionar

- Përcaktimi i driftit të bëhet duke realizuar një sesion matjesh 12-orësh, me matje ciklike minimalisht 60 sekonda dhe interval 5 sekonda midis matjeve.
- Gjatë muajit të parë të punës, korrëktura për drift stacionar të përcaktohet 2 herë në javë; pas kësaj, minimalisht 2 herë në muaj.
- Rezultatet e matjeve evidentohen në tabela të veçanta.
- Vlera e përcaktuar e driftit do të përdoret për rregullimin e faktorit të driftit në instrument, sipas manualit të përdorimit të gravimetrit.

Kalibrimi i gravimetrit relativ

- Koeficienti i kalibrimit (K) llogaritet duke matur 4 herë brenda një dite diferencat e gravitetit midis pikave të bazës horizontale të kalibrimit.
- $K =$ raporti i diferencës së vlerave të gravitetit të bazës horizontale ndaj diferencës së gravitetit të matur me gravimetrin relativ.
- Gravimetri duhet të kalibrohet 3 herë gjatë fushatës: në fillim, mes dhe fund të matjeve.
- Për të eliminuar ndikimin e matjeve të ditës së parë, të gjitha diferencat gravimetrike korrëgjohen me K mesatare nga tre koeficientët e kalibrimit.
- Procesi i matjeve dhe përpunimi i tyre (llogaritja e korrëkturave) realizohet sipas udhëzimeve të fushatës të përcaktuara në këtë projekt.
- Kompensimi i driftit realizohet sipas metodës së kuadrateve më të vegjël, duke përdorur të dhënat e matjeve ditore.

Fushata e matjeve gravimetrike relative të pikave të Rendit të Tretë

1. Stacionimi i gravimetrit në çdo pikë:

- Pastrimi i sipërfaqes mbi të cilën vendoset trekëmbëshi.
- Vendosja e trekëmbëshit dhe gravimetrave.
- Futja e koordinatave të pikës (RTK).

- Nivelimi i gravimetrave me saktësi 10 arcseconds.
- Matja e lartësisë së instrumentit me saktësi 1 mm.
- Shënimi i pozicionit të këmbëzave.
- Stabilizimi i gravimetrit për 10 minuta për të arritur temperaturën e ambientit.

2. Marrja e leximeve:

- Minimum 6 cikle matjesh për të siguruar 5 cikle të vlefshme.
- Parametrat e instrumentit: *kohëzgjatje 60 sek, kohë cikli 77 sek, përdorim i filtrit sizmik PO, korektim horizontimi PO, përjashtim automatik i matjeve të gabuara PO, korektura për baticë-zbaticë PO, ruajtje automatike e të dhënave PO, korektura për modelin e terrenit JO.*
- Matja e temperaturës dhe presionit të ajrit regjistrohet në Bllokun Fushor.
- Matja e lartësisë së gravimetrit në të tre faqet me saktësi 1 mm.
- Vrojtimi i nivelimit të gravimetrit gjatë gjithë kohës (≤ 10 sek) dhe regjistrimi i disturbancave.
- Nëse diferenca e leximeve është $>15 \mu\text{Gal}$ për shkak të disturbancave, matjet përsëriten.
- Mbrojtja e gravimetrit me çadër nëse është i ekspozuar në diell.
- Përfundimi i regjistrimit të matjeve.

3. Transportimi i instrumentave duhet të bëhet me kujdes.

4. Blloku Fushor i Matjeve duhet të përmbajë:

- Data, numri serial i instrumentit, emri i operatorit, identifikatori dhe koordinatat e pikës, lartësia e instrumentave, leximet dhe koha e tyre, temperatura, presioni, prezenca e disturbancave (p.sh., kalimi i kamionëve, goditje instrumenti, ndryshim voltazhi, era e fortë etj.).

Përpunimi dhe kompensimi i matjeve gravimetrike relative

Operatori Ekonomik duhet të ndjekë këto kritere:

1. Korrigjimet për çdo ditë gravimetrike:

- Earth Tide Correction (ETC)
- Filtrimi i efekteve sizmike
- Korektimi për tilt (horizontim)
- Efektet e mundshme të fushës magnetike tokësore
- Korektimi për presion atmosferik
- Korektimi për lartësinë e instrumentit (Gradient Vertikal Normal/Real)
- Korektimi për lëvizjen e polit të tokës
- Ocean Tide Loading
- Korektimi për driftin e gravimetrit stacionar
- Koeficienti i kalibrimit (K) nga baza horizontale

2. Vlerësimi paraprak:

- Devijimi standard nga 6 leximet në çdo pikë $\leq 15 \mu\text{Gal}$
- Devijimi standard i matjeve të përsëritura $\leq 30 \mu\text{Gal}$

3. Kompensimi dhe vlerësimi përfundimtar:

- Metoda e kuadrateve më të vegjël me programe specifike.
- Për llogaritjen e diferencave midis pikave përdoret drift lineare/kuadratike.
- Devijimet standard përdoren si peshë, duke marrë parasysh distancat midis pikave.
- Përfshihen të gjitha diferencat e gravitetit, duke përfshirë pikat absolute dhe të Rendit I & II.
- Matjet me gabime të mëdha përjashtohen (Adjustment Free-Free Outliers, Tau-Test).
- Kompensimi kryhet iterative derisa të arrihet konvergjenca dhe testi statistikor X^2 (Chi-Squared Test).
- Rezultati final duhet të jetë brenda saktësisë së kërkuar: $\leq 30 \mu\text{Gal}$.

LLOGARITJA E GJEODIT GRAVIMETRIK NË SHQIPËRI

Operatori Ekonomik (OE) duhet të realizojë llogaritjen e gjeoidit gravimetrik për territorin e Republikës së Shqipërisë, mbi bazën e të dhënave gravimetrike tokësore, modeleve gjeopotenciale globale dhe modeleve digjitale të terrenit, duke zbatuar metodologjitë bashkëkohore të gjeodezisë fizike, me qëllim llogaritja e gjeoidit gravimetrik lokal me saktësi dhe rezolucion të lartë.

Burimet e të dhënave

OE duhet të përdorë në procesin e modelimit të gjeoidit gravimetrik këto burime të dhënash:

- Të dhëna gravimetrike tokësore:
 - pikat absolute gravimetrike;
 - pikat e rrjetit gravimetrik të Rendit të Parë;
 - pikat e rrjetit gravimetrik të Rendit të Dytë;
 - pikat e rrjetit gravimetrik të Renditit të Tretë, të përfuara nga matjet gravimetrike relative tokësore.
- Të dhëna plotësuese në zonat kufitare tokësore dhe detare:
 - modele gjeopotenciale globale (GGM);
 - të dhëna nga altimetria satelitore;
 - modele digjitale globale të terrenit (DTM);
 - të dhëna historike dhe aktuale nga rrjetet gravimetrike të vendeve fqinje.

Modelet gjeopotenciale dhe modeli i terrenit

Operatori Ekonomik (OE) duhet të përdorë modele gjeopotenciale globale me shkallë të lartë zhvillimi harmonik dhe rezolucion të përshtatshëm për territorin e Republikës së Shqipërisë.

OE duhet:

- të realizojë analiza krahasuese për vlerësimin e përshtatshmërisë së modeleve gjeopotenciale për territorin e Republikës së Shqipërisë;
- të përzgjedhë modelin më të përshtatshëm mbi bazën e rezultateve të këtyre analizave.
- Modelet gjeopotenciale të rekomanduara janë: EGM2008; EIGEN-6C4.

Për korrektimin e efekteve topografike dhe të masave të jashtme, OE duhet të përdorë modelin digjital të terrenit (DTM) të Republikës së Shqipërisë, të përfuar nga skanimi LiDAR (2015).

Reduktimi i të dhënave gravimetrike

OE duhet të reduktojë vlerat e gravitetit nga sipërfaqja e terrenit në sipërfaqen ekuipotenciale të gjeoidit, nëpërmjet aplikimit të korigjimeve të mëposhtme:

- korigjimi Ajër-Lirë (*Free-air correction*);
- korigjimi Bouguer;
- korigjimi i terrenit/topografisë (*Terrain/Topography correction*);
- korigjimët atmosferike;
- efektet e tjera fizike të jashtme të nevojshme për përfundimin e anomalive të reduktuara të gravitetit.

Reduktimi i masave topografike drejt sipërfaqes së gjeoidit duhet të realizohet duke përdorur metoda numerike të njohura të gjeodezisë fizike, si më poshtë:

- metoda Helmert;
- metoda Rudzki;
- metoda RTM (Residual Terrain Model);
- metoda Airy–Heiskanen;
- metoda Pratt–Hayford, ose metoda të tjera ekuivalente shkencërisht të pranuar.

OE duhet të argumentojë zgjedhjen e metodës së përdorur për reduktimin topografik mbi bazën e analizave krahasuese të ndikimit në saktësinë përfundimtare të modelit të gjeoidit gravimetrik.

Metodat e llogaritjes së gjeoidit gravimetrik

OE duhet të llogarisë gjeoidin gravimetrik (W_0) duke përdorur metoda numerike të njohura të gjeodezisë fizike, si më poshtë:

- metoda Least Squares Modification of Stokes (LSMSA/KTH) me korrekture shtesë (additive corrections);
- metodat FFT njëdimensionale dhe dydimensionale (Fast Fourier Transform);
- metoda Least Squares Collocation (LSC),

ose metoda të tjera ekuivalente të pranuar shkencërisht.

Për qëllime verifikimi dhe vlerësimi të saktësisë së modelit të gjeoidit, OE duhet të realizojë llogaritjen e gjeoidit gravimetrik minimalisht me dy metoda të pavarura dhe të kryejë analizë krahasuese të rezultateve të përfutur.

Sipërfaqja ekuipotenciale (gjeoidi gravimetrik) dhe referenca vertikale

OE duhet të përcaktojë sipërfaqen ekuipotenciale lokale të gjeoidit gravimetrik (W_{0i}) në lidhje me këto referenca vertikale:

- a) niveli mesatar i detit (MSL), i përfutur nga stacioni mareografik i Durrësit (2018–2026), referuar TGBM;
- b) pikave klasike ALB86, bazuar në MSL (1958–1977) të stacionit mareografik historik të Durrësit.

Gjeoidet duhet të përcaktohen në sistemin: zero-tide dhe tide-free në referencë koordinativ KRGJSH (ETRS89/ETRF2000, ep. 2014.177).

Kontrolli dhe vlerësimi i modelit të gjeoidit

OE duhet të vlerësojë saktësinë e modelit të gjeoidit përmes:

- llogaritjes së gjeoidit me të paktën dy metoda të ndryshme;
- krahasimit të lartësive ortometrike të reperave të vijave të nivelimit Durrës–Tiranë dhe Vorë–Shëngjin (viti 2024), referuar MSL të stacionit mareografik të Durrësit;
- krahasimit me lartësitë e pikave ekzistuese të rrjetit ALB86.

Llogaritja e gjeoidit hibrid

OE duhet të llogarisë dy modele gjeoidi hibrid (GNSS/Nivelim), përkatësisht:

- a) referuar reperave të vijave të reja të nivelimit Durrës–Tiranë dhe Vorë–Shëngjin, bazuar në MSL të stacionit mareografik të Durrësit;
- b) referuar pikave të referencës klasike ALB86.

Produktet finale

Gridi i gjeoidit duhet të krijohet në varësi të dendësisë së pikave gravimetrike ose sipas një rrjete të rregullt $1' \times 1'$.

OE duhet të dorëzojë produktet përfundimtare në formate standarde ndërkombëtare, të përshtatshme për përdorim në marrës GNSS dhe në sisteme GIS, si më poshtë:

1. Gjeoidi gravimetrik W_0 ;
2. Gjeoidi gravimetrik lokal W_{0j} (MSL – Mareografi i Durrësit);
3. Gjeoidi hibrid GNSS/Nivelim_MSL_TG_Durrës;
4. Gjeoidi hibrid GNSS/Nivelim_ALB86.

DEYRIMET E ASIG

ASIG është përgjegjës për vënien në dispozicion ndaj Operatorit Ekonomik të të dhënave:

1. Të dhënat për Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit Zero
2. Të dhënat për Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Parë
3. Të dhënat për Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Dytë
4. Të dhënat për Rrjetin Shtetëror Gravimetrik të Rendit të Tretë
5. Të dhënave për dy vijat e nivelimit Durrës-Tiranë dhe Vorë-Shëngjin.
6. Të dhënat e nivelit mesatar të detit të regjistruara nga Rrjeti i Stacioneve Mareografik.
7. Të dhënat ekzistuese GNSS/Leveling të referencës klasik ALB86.
8. DTM-in e përfutur nga skanimi Lidar 2015.

AFATI I REALIZIMIT TË PROJEKTIT

Realizimi i projektit fillon nga momenti i nënshkrimit të kontratës dhe do të zgjasë për një periudhë 6 (gjashtë) muaj. Operatori Ekonomik është i detyruar të angazhojë burimet e nevojshme njerëzore për të siguruar realizimin cilësor brenda afatit kohor të përcaktuar.

Në tabelën e mëposhtme, Operatori Ekonomik duhet të respektojë kohështrirjen e aktiviteteve të përcaktuara për realizimin e projektit.

Nr.	Aktivitetet	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6
1	Rikonicioni në terren dhe fiksimi i pikave të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë	•	•	•			
2	Realizimi i matjeve gravimetrike, si dhe përpunimi dhe kompensimi i të dhënave gravimetrike		•	•	•	•	
3	Realizimi i matjeve GNSS (RTK dhe statike), si dhe përpunimi dhe kompensimi i të dhënave GNSS (statike)		•	•	•	•	
4	Llogaritja dhe vlerësimi i modelit të gjeoidit gravimetrik					•	•
5	Hartimi i raporteve teknike dhe dorëzimi i produkteve përfundimtare						•

Tabela 10.1. Aktivitetet kryesore të projektit dhe kohëzgjatja e tyre

Shënim: Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë çdo 30 ditë, pas nënshkrimit të kontratës, një raport paraprak mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

DORËZIMI I PRODUKTIT FINAL

Operatorit Ekonomik është i detyruar që të realizojë të gjitha aktivitetet e parashikuara sipas afateve kohore të përcaktuara më lart, si dhe duhet të marrë të gjitha masat që produkti final të jetë me cilësinë dhe saktësinë e kërkuar.

Për këtë qëllim do të hartohet dhe procesverbali i dorëzimit përfundimtar i cili do të përmbajë të gjitha aktivitetet e përcaktuara për t'u realizuar gjatë zbatimit të këtij projekti.

Afati përfundimtar për dorëzimin e të gjithë produktit: 6 muaj nga momenti i lidhjes së kontratës.

Me përfundimin e punimeve dhe shërbimeve, Operatori Ekonomik do të dorëzojë pranë ASIG:

Raportin teknik përfundimtar i cili duhet të përmbajë (hardcopy dhe digjital)

1. Raportin e zgjedhjes së pozicionit gjeografik dhe fiksimit e pikave të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë për pjesën qendrore dhe jugore të Republikës së Shqipërisë, ku duhet të përshkruhet plotësimi i kriterëve për çdo pikë të shoqëruara me formularin fushor sipas kërkesave përkatëse të kërkuara në kapitullin “6. Rikonicioni fushor i pikave të Rrjetit Gravimetrik”.
2. Raportin e detajuar mbi Rrjetin Gravimetrik të Rendit të Tretë (pjesa qendrore dhe jugore), ku duhet të shpjegojë në mënyrë të hollësishme planifikimin, organizimin, procesin e matjeve fushore të shoqëruar me bllokun e matjeve fushore përkatëse ku shënohen (emërtimi i pikave, koordinatat e pikave, koha e matjeve, latësia e instrumentit, matja e presionit dhe temperaturës së ajrit etj), përpunimin, kompensimin dhe llogaritjen e vlerës së gravitetit përfundimtar, të shoqëruar me analizën e saktësisë për çdo pikë sipas kërkesave përkatëse të kërkuara në kapitullin “7. Matjet gjeodezike të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë dhe përpunimi i tyre (pjesa qendrore dhe jugore)”.
3. Raportin e detajuar mbi matjet GNSS (RTK/Statike) në pikat e Rrjetit Gravimetrik të

Rendit të Tretë (pjesa qendrore dhe jugore), ku duhet të shpjegojë në mënyrë të hollësishme planifikimin, organizimin, procesin e matjeve fushore, përpunimin, kompensimin dhe llogaritjen e koordinatave përfundimtare, të shoqëruar me analizën e saktësisë për çdo pikë sipas kërkesave përkatëse të kërkuara në kapitullin “**7. Matjet gjeodezike të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë dhe përpunimi i tyre (pjesa qendrore dhe jugore)**”.

4. Raportin e detajuar mbi llogaritjen dhe vlerësimin e Gjeoidit Gravimetrik, ku duhet të shpjegojë në mënyrë të hollësishme dhe të qartë llogaritjen e gjeoidit dhe saktësinë e arritur sipas kërkesave përkatëse të kërkuara në kapitullin “**8. Llogaritja e Gjeoidit Gravimetrik në Shqipëri**”.

Dorëzimi i të dhënave

1. Matjet fushore gravimetrike (Raw Data) dhe përpunimin e tyre në format digjital.
2. Matjet fushore GNSS (Raw Data) dhe përpunimin në format digjital.
3. Monografia e pikave të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë (pjesa qendrore dhe jugore).
4. Produktet e Gjeoidit Gravimetrik sipas formateve standard globale të njohura nga brand-et e marrësve GNSS për përdoruesit, si dhe sipas formateve standarde që mundësojnë përdorimin e gjeoidit në programet aplikative GIS.

Shënim: Të gjitha të dhënat e mësipërme duhet të dorëzohen në 2 kopje në HDD.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Ndërtimi i Pjesshëm i Kornizës Referuese Gjeodezike, Faza VI”

“NDËRTIMI I PJESSHËM I KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE, FAZA VI” DENDËSIMI I MATJEVE GRAVIMETRIKE TË RENDIT III (PJESA QENDRORE DHE JUGORE TË SHQIPËRISË) LLOGARITJA E GJEODIT GRAVIMETRIK			
Nr.	Aktivitetet e Projektit	Njësia	Sasia
1	Rikonicioni në terren dhe fiksimi i pikave të Rrjetit Gravimetrik të Rendit të Tretë	pika	615
2	Realizimi i matjeve gravimetrike, si dhe përpunimi dhe kompensimi i të dhënave gravimetrike	pika	615
3	Realizimi i matjeve GNSS (RTK dhe statike), si dhe përpunimi dhe kompensimi i të dhënave GNSS (statike)	pika	615
4	Llogaritja dhe vlerësimi i modelit të gjeoidit gravimetrik	copë	1
5	Hartimi i raporteve teknike dhe dorëzimi i produkteve përfundimtare	copë	1

Afatet e ekzekutimit: 6 (gjashtë) muaj nga nënshkrimi i kontratës

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: NDËRTIMI I PJESSHËM I KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE, FAZA VI”, Dendësimi I Matjeve Gravimetrike Të Rendit III, (Pjesa Qendrore Dhe Jugore Të Shqipërisë) Llogaritja E Gjeoidit Gravimetrik

Detyrat: Kryerja e shërbimit me saktësi dhe rezolucion të lartë hapësinor konform specifikimeve të kërkuara

Shpërndarja: sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: *sipas specifikimeve teknike.*

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

